



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 143/1 Prot.

Tiranë, më 16/02/2023

VENDIM

Nr. 5, datë 16/02/2023

MBI

**“MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË PËRCAKTUAR NGA OSSH SH.A. PËR
VENDOSJEN E PIKËS SË LIDHJES PËR GABINËN ELEKTRIKE”**

Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve, në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Vendimit nr. 166, datë 10.10.2016 të ERE “Për miratimin e rregullores së lidhjeve të reja, marrëveshjes së lidhjes së re dhe formularit të aplikimit për lidhjen e re”, VKM nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje, kolaudim”, në kuadër të projektit me objekt “Projekt zbatimi i restaurimit, rikonstruksionit dhe rinovimit të sallës së koncerteve në UART, Tiranë”, sipas kontratës nr. 904/12 prot., datë 02.04.2021 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe BOE “K.A.E.XH” sh.p.k. dhe “U.R.T” sh.p.k., pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin e vlerës financiare në përputhje me faturën e lëshuar nga OSSH sh.a., sipas dokumentacionit bashkëlidhur, për vendosjen e pikës së lidhjes për gabinën e re elektrike, në kuadër të restaurimit, rikonstruksionit dhe rinovimit të sallës së koncerteve në UART.

2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Laydrim SAHITAJ

(Kryetar)

Jeton SHEHU

(Anëtar)

Ergis SEFA

(Anëtar)

Prof. Besnik Bisha

(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI

(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

(Anëtar)

Vladimir LLAKAJ

(Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ADMINISTRATOR

Nr. 143 Prot.

03/02/2023
Tiranë, më 26/01/2023

Lënda: Kërkesë për miratim

Bordit të Administrimit

Në realizimin e projektit me objekt "Projekt zbatimi i restaurimit, rikonstruksionit dhe rinovimit të sallës së koncerteve në UART, Tiranë" sipas kontratës Nr.904/12 prot, datë 02.04.2021, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe BOE "K.A.E.XH "sh.p.k dhe "U.R.T" sh.p.k, është parashikuar që për arsye të ngarkesës të paisjeve, të cilat do të funksionojnë në këtë sallë, të ndërtohet një gabinë elektrike më vete, e cila tashmë është ndërtuar nga ana e shoqërisë zbatuese të punimeve.

Për vendosjen e pikës së lidhjes për gabinën e re elektrike, vlera që duhet të paguajë UART, sipas dokumentit bashkangjiur, është 1,018,545 lekë.

Kërkojmë miratimin nga ana Juaj të vlerës së mësipërme, për kryerjen e pagesës, me burim financimi të ardhurat e vitit 2023.

Bashkëngjitur gjeni faturën e lëshuar nga OSSH.

Alma Sinanaj
ADMINISTRATOR

Cost Estimation Details



Nr i serisë: L320230109978

Date: 24-1-2023

Emri i Shoqërisë: Universiteti i Arteve

Numri i Kontratës: -

Preventiv

Klienti	Universiteti i Arteve
Adresa	Rr Bul D Kombit, 4/848,...
T1 - Tarifa e studimit dhe vlerësimit e miratimit të projektimit	23000 LEK
T2 - Tarifa e distances	4500 LEK
T3 - Tarifa e fuqisë (lekë / kw fuqi të kërkuar) (Cost per Unit : 1700 LEK * Load : 480 KW)	816000 LEK
T4 - Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes	5288 LEK
Shuma	848788 LEK
TVSH : 20%	169757 LEK
Totali	1018545 LEK

Inxhinieri i lidhjeve të reja

Ing (Ervin Mele)

Date: 24-1-2023 14:53:31

Vo: Nëse kjo pagesë kryhet në bankë, të shënohet në përshkrimin e mandalit të pagesës, emri i klientit siç është në preventiv dhe numri i serisë së aplikimit L320230109978

Kjo pagesë mund të kryhet në bankë nëpërmjet llogarive të mëposhtme:

Banka Kombetare Tregtare: AL3120511014005332CLPBOLALLM

Credins Bank: AL72 2121 1016 0000 0000 0131 4720

Raiffeisen Bank: AL202021100600000000001446960

A: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.I, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirana, Albania

NIPT: L81530018E